



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016-15021

Më datë 03.04.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 17, i Ligjit Nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013” dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016”, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-së për fshatin rekreativ turistik në “Delloc”

1. Me qëllim të ofrimit të vizionit, qëllimit dhe objektivave në procesin e planifikimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc”, e që duhet të definohe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, formohet Ekipi Komunal i Planifikimit për PRrH-në fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc” në këtë përbërje:
 - 1.1 Visar KUÇI-----Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
 - 1.2 Doruntina BYTYQI- -----Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
 - 1.3 Albulena KUÇI -----Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
 - 1.4 Elona KUÇI -----Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
 - 1.5 Florinda ISUFAJ----- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
 - 1.6 Kymete BAJRAKTARI-- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
 - 1.7 Avni BYTYÇI-----Zyra Ligjore
 - 1.8 Emrush BYTYQI--Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
 - 1.9 Ardita KOLGECI-----Drejtoria për Administratë
 - 1.10 Liridona ASLLANAJ-----Drejtoria për Inspektion
 - 1.11 Agim BYLYKBASHI-----Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet,
 - 1.12 Armend KRASNIQI-----Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
 - 1.13 Memi GOLLOPANI-----Qendra për punë sociale
 - 1.14 Refki GOLLOPANI-----Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë
 - 1.15 Atedhe BUZHALA-----Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
2. Udhëheqëse i Ekipit Komunal për Planifikim për PRrH-në fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc” sipas detyrës zyrtare, emërohet z. **Visar KUÇI**.
3. Koordinator i Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-së fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc” për koordinimin e punëve të Ekipit Komunal për Planifikim të PRrH-në fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc” dhe kompanisë “INSI” Sh.P.K me seli në Prishtinë, është z. **Bajram SHALA**.
4. Detyra e Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) është të punojnë në hartimin e PRrH-së për fshatin rekreativ turistik në fshatin “Delloc” në bashkëpunim me

kompaninë "INSI" Sh.P.K me seli në Prishtinë, konform Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013" dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

5. Anëtarët e EKP-së obligohen që të ofrojnë përkrahjen e tyre profesionale dhe intelektuale nga fushë-veprimtaria e drejtorisë përkatëse. Në moment kur kërkohen informata dhe propozime profesionale nga lëmi që ofron drejtoria përkatëse, anëtari përfaqësues i drejtorisë mund të kërkojë nga zyrtarët kompetent brenda drejtorisë por edhe jashtë saj siç janë: intelektualë, ekspertet të pavarur, shoqata të ndryshme e të ngjashme (në këto raste duhet të mbahet evidenca e ofruesit të informatës respektivisht idesë dhe propozimit në dosje).
6. EKP-ja obligohet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, shoqatat, grupet e interesit, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të Komunës e të ngjashme, në kuptim të gjithëpërfshirës dhe rritjes së cilësisë të PRrH-së për fshatin rekreativ turistik në fshatin "Delloc".
7. Ndërsa mandati i EKP përfundon me miratimin e PRrH-në fshatin rekreativ turistik në fshatin "Delloc" nga Kuvendi të Komunës në Suharekë.
8. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ

I dorëzohet:
DUP-së
Anëtarëve të ekipit,
Në dosje,